

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr. 4204/L prot.

Tiranë, më 06.08.2026

Lënda: Shpallje për subjektin "EURODIVERSEY AL", me NIPT:M31312031A

DREJTUAR: SUBJEKTIT EURODIVERSEY, ME NIPT:M31312031A

Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Tiranë, Rajoni I, ka kryer inspektim në subjektin EURODIVERSEY, me nipt:M31312031A, me adresë: Rruga "Shaban Bardhoshi", Z.K.8230. me nr pasurie 2/411,Tiranë dhe në përfundim të procesit të inspektimit në mbështetje të ligjit 9634, datë 30.10.2006 "Për inspektimin në Punë" i ndryshuar, është marrë vendimi përfundimtar i inspektimit me nr.ISHPSHSH-TR-2026-003058-5, datë 17.07.2026, ku ndaj subjekti është ndërmarrë masë administrative me gjobë në vlerën 50000 (pesëdhjetë mijë) lek.

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji 99/2024, datë 12.09.2024 "Për Inspekimin në Republikën e Shqipërisë" njoftimi i subjektit për këtë vendim përfundimtar nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë.

Bazuar në nenin 162 i Ligjit Nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ISHPSHSH Rajoni I ka vendosur njoftimin e subjekti EURODIVERSEY, me nipt:M31312031A, me adresë:Rruga Shaban Bardhoshi,Z.K.8230.me nr pasurie 2/411,Tiranë, për njohjen më këtë Vendim Përfundimtar të Inspektimit me anë të shpalljes së këtij njoftimi duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së Tiranë me adresë Rruga Sheh Ahmet Pazari,Tiranë; në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim; në QKB; në mjediset e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare të web të ISHPSHSH-së.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes. Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti "EURODIVERSEY AL" ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë ISHPSHSH-së, në nivel Qëndror të "Komisioni i Ankimit të ISHPSHSH-së".

Për njohjen me përmbajtjen e plotë të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë ISHPSHSH-së Tiranë me adresë Rruga Sheh Ahmet Pazari.

Ky njoftim shpallet sot më datë 06.08.2026 dhe do të qëndrojë i afishuar deri në datë 16.08.2026 në mjediset e ISHPSHSH-së në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim.

KRYEINSPEKTOR RAJONAL

Ardit Shabanaj

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

PËRGJEGJËS INSPEKTIMI

Armando Loga

